



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT TË
INDUSTRIËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN
E MINIERAVE DHE INDUSTRIËS**

Nr. 9108/11 prot.

Tiranë, më 28.10.2019

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi të lejes nr.1862, datë 16.07.2018.

SHOQËRISË “TOMORRI - B” SH.P.K
Lagjia “Kthesa e Lapardhasë” Godina nr.15, Buzë Rrugës Nacionale km 8,
Fshati Otllak, Berat.

Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Blloku “Vasil Shanto”, Nr.18, Tiranë.

AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË MINIERA
Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.

Shoqëria “Tomorri B” sh.p.k është zotëruese e lejes minerare të shfrytëzimit nr.1862, datë 16.07.2018, për mineral gëlqeror pllakor, në objektin “Novaj”, Skrapar, Qarku Berat.

Nga struktura përgjegjëse e AKBN-së me shkresën nr.6361, datë 21.10.2019, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me nr.9108, datë 22.10.2019 dhe me shkresën nr. 6161, datë 21.10.2019, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me nr.9099, datë 22.10.2019, është propozuar revokimi i lejes minerare të shfrytëzimit nr.1862, datë 16.07.2018, për mineral gëlqeror pllakor, në objektin “Novaj”, Skrapar, Qarku Berat, për arsye se:

- Nuk ka filluar aktivitetet minerar në zonën për të cilën është dhënë leja minerare brenda 180 diteve, që është afati i përcaktuar ligjigjor për të filluar punë.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore për revokim, është i mbështetur në paragrafi “ii” i gurmës “b”, të pikës 1, të nenit 47, (neni që përcakton shkeljet ligjore për të cilat një leje revokohet), të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të nenit 48, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare të shfrytëzimit nr.1862, datë 16.07.2018, për mineral gëlqeror pllakor, në objektin “Novaj”, Skrapar, Qarku Berat, që shoqëria juaj zotëron.**

Ju bëjmë me dije se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes shfrytëzimit nr.1862, datë 16.07.2018, për mineral gëlqeror pllakor, në objektin “Novaj”, Skrapar, Qarku Berat.

Në zbatim të nenit 49, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitet minerar.

Ju faleminderit për mirëkuptimin!

MINISTRI
BELINDA BALLUKU

ME AUTORIZIM
ZËVENDËSMINISTRI
ILIR BEJTJA

